

VENDIM
Nr. 26, datë 21.3.2014

**MBI KËRKESËN E NJË PREJ AKSIONARËVE TË SHOQËRISË “PROJEKSION ENERGJI” SHA
PËR HEQJEN E LICENCËS DHE ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES MIDIS PALËVE**

Në mbështetje të neneve 8, germa “d” dhe 9, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 36 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 18 germa “b” i Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, lidhur me kërkesën e një prej aksionarëve të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., për heqjen e licencës nr. 40, seria PV06P, për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”, konstatoi se:

- Shoqëria “Projeksion Energji” sh.a., me vendimin nr. 76, datë 7.11.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me licencën e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”.
- Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 47, datë 18.4.2008, ka miratuar kërkesën e shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., për ndryshimin e licencës nr. 40, seria PV06P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet “Çarshovë”, “Treska 1” dhe “Rehovë”.
- Aktualisht shoqëria është pa status ligjor nga pamundësia numerike e aksionarëve për të marrë vendim. HEC “Çarshovë” ka kaluar në pronësi të trashëgimtarëve, të ish-pronarëve që e kanë privatizuar. HEC-et “Rehovë” dhe “Treska-1”, siç del dhe nga monitorimi i bërë nga grupi i ERE-s dhe nga akuzat e ndërsjella të aksionarëve janë të dëmtuar nga vetë poseduesit, marrëdhëniet e shoqërisë me institucionet që operojnë janë të provokuara nga akuzat e aksionarëve, dhe marrëdhëniet konfliktuale ndërmjet tyre e kanë çuar shoqërinë për prishje në gjykatë.
- Bazuar në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, shoqëria “Projeksion Energji” sh.a. nga të dhënat e ekstrakteve të QKR-së rezultojnë të prishur dhe çregjistrimi i saj do të bëhet në bazë të nenit 48-51 me vendim gjyqësor të paankimueshëm për ndarjen e kapitalit (me vërtetimin datë 18.2.2013 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prishja e kësaj shoqërie është objekt gjykimi).
- Kërkesa për heqje licence vjen nga njëri nga aksionarët e shoqërisë dhe jo nga forumet drejtuese të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a.
- Çështjet ku bazohet kërkesa për heqje licence janë objekt konflikti gjyqësor ndërmjet aksionarëve të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., siç dëshmohet me vërtetimin e datës 18.2.2013 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Civile, rezultojnë se pranë kësaj Gjykate është regjistruar çështja civile me nr. 624 Akti, datë depozitimi 8.3.2012 dhe datë regjistrimi 12.3.2012. Palët ndërgjyqëse në këtë proces rezultojnë të jenë: paditës z. Sokol Riska, i paditur z. Anastas Riska dhe palë e tretë QKR-ja. Objekti i gjykimit është: Prishja e shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a., ndarje e aseteve në përpjesëtim me zotërimin e aksioneve të secili. Vlen të theksohet fakti se kjo çështje është ende në gjykim.
- Në bazë të nenit 8, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka kompetencë vetëm të zgjidhë mosmarrëveshjet midis të licencuarve. Çdo mosmarrëveshje e lindur midis aksionarëve të shoqërive të licencuara duhet të zgjidhet në gjykatë. Po ashtu Kodi i Procedurës Civile, në nenin 36 paragrafi i dytë shprehet qartë se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Dhe Kodi i Procedurës Administrative në nenin 18, germa “b”, përcakton se: “Në mënyrë që të mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave privatë, veprimtaria administrative i nënshtrohet: kontrollit nga gjykatat në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a.
 2. Shpalljen e moskompetencës së ERE-s për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve midis aksionarëve të “Projeksion Energji” sh.a.
 3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti